

DR. SALIH BIN FEUZAN EL FEUZAN

POZITA E
SUNETIT NË ISLAM

OJQ “Njëshmëria” Gjilan

Titulli në origjinal:

“MEKANETU SUNEH FIL ISLAM”

Autori:

Dr. Salih bin Feuzan el Feuzan

(Anëtar i Komisionit të Përhershëm për Fetva dhe anëtar i Departamentit të Dijetarëve të Mëdhenj në Arabinë Saudite, Riad)

Përktheu nga origjinali:

Rashit R. Zylfiu

Redaktor-fetar:

Alaudin Abazi

Korrektor letrar:

Arjan Koçi

Ballina:

Jeton Ibrahim

Radhitja kompjuterike:

Avni G. Gashi

Boton: OJQ “Njëshmëria” Botime, Gjilan

Tirazhi: copë

Botimi i parë:

1433h /2012

Info: Tel. +386/049 150 712

Web:[www.njeshmeria.org&](http://www.njeshmeria.org&info@njeshmeria.gmail.com)

info@njeshmeria.gmail.com

I Dërguari, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Kush jeton prej jush pas meje do të shohë mospajtime të shumta. Kapuni për Sunetin tim dhe të kalifëve të drejtë e udhëzues. Kapuni për to me dhëmballë dhe kini kujdes prej gjërave të shpikura se çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje."*¹

¹ Shënon Ebu Davudi, 4/20 nr. 4607, Tirmidhiu 5/44/ nr. 2676, Ibn Maxhe'h, 1/10 nr. 42 dhe Ahmedi 4/126.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Lavdërimi, shpëtimi dhe përshëndetjet qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamedin, i cili ka thënë: *"Me të vërtetë mua më është dhënë Kurani dhe diçka e ngjashme me të (Suneti)."*²

Allahu i Madhërishëm e dërgoi Muhamedin, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, me udhëzim dhe fenë e vërtetë. Ai ishte përgëzuesi, qortuesi, ndriçuesi dhe ai udhëzoi atë që ishte i humbur, predikoi Islamin e qartë, derisa e la umetin e tij në të vërtetën, në të cilën nata e saj është sikurse dita.

Pejgamberi Muhamed, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Pas meje kam lënë për ju dy gjëra, nëse kapeni për to, nuk do të humbni, pas meje kurrë; librin e Allahut (Kuranin) dhe Sunetin tim."*³

I Dërguari, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Kush jeton prej jush pas meje do të shohë mospajtme të shumta. Kapuni për Sunetin tim dhe të kalifëve të drejtë e udhëzues.*

*Kapuni për to me dhëmballë dhe kini kujdes prej gjërave të shpikura se çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje."*⁴

Tema për të cilën do të flasim është Suneti profetik dhe pozita e tij në Islam.

²Shënon Ahmedi, 4/130.

³ShënonMaliku, 2/899/ nr. 1594.

⁴ Shënon Ebu Davudi, 4/20 nr. 4607, Tirmidhiu 5/44/ nr. 2676, Ibn Maxhe'h, 1/10 nr. 42 dhe Ahmedi 4/126.

Kuptimi i fjalës sunet në aspektin gjuhësor

Në aspektin gjuhësor, sunet ka kuptimin e rrugës. Allahu i Madhërishëm në Kuran thotë: ***"Vallë, a presin ata diçka tjetër veç rrugës së atyre që ishin para tyre? Vërtet, Ti nuk mund të gjesh ndryshim ose shndërrim në ligjet e Allahut."*** (Fatir: 43)

D.m.th. rrugë ose traditë në të cilën ka vepruar ligji i Allahut mbi gënjeshtarët dhe kundërshtarët e të Dërguarve. Suneti (ligji) i Allahut mbi ta është që t'i ndëshkojë me dënim për kundërshtimin e të Dërguarve.

Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: ***"Do t'i pasoni (sunetet) rrugët e atyre që ishin para jush..."***⁵ Kjo aludon se sunet ka për qëllim rrugën (diçka që ndiqet) në aspektin gjuhësor.

Kuptimi i sunetit në aspektin terminologjik

Te dijetarët e hadithit, usulit dhe të fikhut, sunet konsiderohet ajo që është përcjellë nga Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, qoftë ajo fjalë, vepër ose pëlqim i tij. Ndërsa disa kanë shtuar edhe cilësitë dhe karakteristikat e tij. Pra, ajo që është vërtetuar prej këtyre gjërave se është nga Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, është sunet i tij. Ky është përkufizimi i sunetit te dijetarët e shariatit.

Rëndësia dhe pozita e Sunetit në Islam

Pozita e sunetit është e madhe, vendi i tij është madhështor, ngase është tradita e Pejgamberit, lav-

⁵Shënon Buhariu, 3/3269 nr. 3269 dhe Muslimi 4/2054/ nr. 2669.

dërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Është burimi i dytë pas Kuranit, ngase baza e parë e fesë është Kurani, i cili iu shpall të Dërguarit me udhëzim e qartësi. Ndërsa baza e dytë është Suneti i Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, e pas kësaj, të gjitha bazat e tjera argumentuese i referohen Kuranit dhe Sunetit.

Esenca e burimeve argumentuese në Islam është Kurani dhe Suneti, siç ka porositur Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:⁶ *"Pas meje kam lënë për ju dy gjëra, nëse kapeni për to, nuk do të humbëni, pas meje kurrë; librin e Allahut (Kuranin) dhe Sunetin tim."*⁷

Suneti është shpallje nga Allahu i Madhërishëm, Ai në Kuran thotë: ***"Ai (Muhamedi) nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij."***

(Nexhm:2-3)

Suneti është shpallje prej Allahut të Madhërishëm, që i është shpallur Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Ai ua predikoi këtë shpallje njerëzve për atë që ishte urdhëruar dhe ndaluar. Suneti gjithashtu është shpjegues i Kuranit, komentues dhe qartësues i tij, shtjellon çështjet, përkufizon gjërat dhe veçon detajin, anulon disa nga dispozitat e tij dhe vjen me dispozita shtojcë që nuk janë të përmendura në Kuran.

Nga këtu gjithmonë e më shumë na qartësohet rëndësia e Sunetit të Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ngase ai është komentues i Kuranit dhe shpjegues i tij. ***"Ty ta zbritëm***

⁶ *"Sal-lAllahu alejhi ue sel-lem"* - Lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të.

⁷ Shënon Maliku, 2/899/ nr. 1594.

Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre." (En Nahl: 44)

Allahu, subhanehu ue teala,⁸ e zbriti Kuranin dhe e autorizoi për shpjegimin e tij Pejgamberin, sal-Allahu alejhi ue sel-lem dhe ky shpjegim është Suneti, siç thotë Allahu, subhanehu ue teala: "*Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t'u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit).*" (Ibrahim: 4)

I Dërguari, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, erdhi që t'ia shpjegojë umetit atë që ka ardhur në Kuran dhe prej shembujve të këtij shpjegimi është se Allahu, subhanehu ue teala, ka urdhëruar për namaz në Kuran, po nuk e ka shpjeguar numrin e rekateve të namazit të sabahut, drekës, iki-ndisë, akshamit, jacisë, por ka urdhëruar me një urdhër të përgjithshëm.

Allahu, subhanehu ue teala, thotë: "*...fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar .*" (El-Ankebut: 45)

"E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin ." (El Bejjine: 5)

"Në qoftë se pendohen, e falin namazin." (Et Tevbe: 5)

Ajetet e tilla janë të shumta. Gjithashtu ka urdhëruar për faljen e namazit por nuk i ka shpjeguar kohët e saj, duke i përmendur me një përmendje të përgjithshme, si në fjalën e Tij: "*Kryeje namazin prej kthimit të Diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në agim; me të*

⁸ "Subhanehu ue teala" - "Qoftë i pastër nga të metat dhe qoftë i madhëruar Allahu".

vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt)."(El Israë: 78)

Dhe në fjalën e Tij: *"Prandaj lavdërojeni Allahun, kur bie muzgu dhe, kur gdhin drita! Për Atë është falënderimi në qiej dhe në Tokë, në mbrëmje dhe në mesditë."*(Er Rrum: 17-18)

Kjo është përmendje e kohëve të namazit, porse me një përmendje të përgjithshme. Ndërsa ajo që i shpjegon këto është Suneti i Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Ai është falur si iman i sahabëve dhe ka thënë: *"Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur."*⁹ Me këtë shpjegim ai tregoi numrin e rekateve të namazeve, që të falemi siç i ka falur ai: dreka, ikindia dhe jacia me nga katër rekate, por nga dy në udhëtim duke i shkurtuar; akshami tre rekate, edhe në udhëtim po ashtu; sabahu dy rekate, edhe në udhëtim dy.

Ndërsa sa u përket kohëve të namazit, Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, i ka shpjeguar kohët se kur duhet të falen dhe i fali të gjitha në kohën e vet, siç thuhet në hadithin e saktë, "se Xhibrili i ka dalë imam Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, në fillim të kohës dhe në mbarimin e saj dhe ka thënë: *"Namazi është në mes këtyre dy kohëve."*¹⁰

Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka shpjeguar numrin, mënyrën dhe kohët e namazit. Pa Sunetin nuk do të mund t'i dinim këto gjëra, edhe pse e kemi ditur obligueshmërinë e tij nga Kur'ani Fisnik. Allahu, subhanehu ue teala, e ka autorizuar Pejgamberin, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, për ta shpjeguar Kuranin. Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, është shpjegues gojor

⁹Shënon Buhariu 1/226 nr. 605.

¹⁰Shënon Ebu Davudi 1/108 nr. 393, dhe Tirmidhiu 1/278 nr. 149.

dhe praktik. Kur një delegacion i havarixhëve¹¹, që e refuzonin Sunetin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, shkoi tek Omer bin Abdulazizi, ai debatoi me ta për çështjen e obigueshmërisë së argumentimit me Sunet. Omeri u tha atyre: "Allahu subhanehu ue teala na ka urdhëruar me namaz në Kur'an, por si të falemi? Sillni një ajet që shpjegon mënyrën e të falurit." Në atë moment u befasuan dhe kështu ua ndërpreu pretendimet dhe argumentet dhe i detyroi të argumentohen me Sunet.

Ashtu si me namazin, Allahu ka urdhëruar edhe për dhënien e zekatit në Kur'an, por si ta dimë pasurinë për të cilën jemi obliguar të japim zekat? Kjo njohje vjen vetëm nga Suneti i Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, që na ka shpjeguar zekatin. Ne jemi të obliguar ta japim atë në ar, argjend, drithëra, fruta, në kafshë dhe në mallra tregtie. Zekati nuk është obligim për të gjithë pasurinë, por vetëm për pasuritë e kultivuara, të përmendura më lart. Ai ka shpjeguar edhe sasinë e duhur për dhënien e zekatit. p.sh.:

- në zekatin e drithërave, frytave dhe perimeve merret 0,10¹² ose 0,05, varësisht sipas ujitjes natyrore dhe asaj artificiale;
- prej arit dhe argjendit merret 1,4/10;
- nga çdo kope që ka 40 dele merret një dele dhe kështu me radhë; me rritjen e numrit të kopësë rritet edhe numri i deleve që duhet të jepen për zekat.

Sasia e zekatit në deve:

- nga çdo pesë deve jepet një dele,

¹¹Havarixhët janë grupacioni i parë që u paraqit në historinë islame. Nga besimi i tyre është se kush bën mëkat të madh, del nga Islami. Ata nuk e marrin Sunetin si burim argumentues të fesë.

¹²1/10 jepet nëse ujitja është natyrore, ndërsa nëse ujitja është artificiale jepet gjysma e 1/10.

- nga dhjetë dy dele,
- nga pesëdhjetë, tri dele,
- nga njëzet, katër dele,
- nga njëzetepesë deve jepet një deve e vogël femër, e cila ende nuk ka mbushur një vit,
- nga njëzetegjashtë deve jepet një deve që ka mbushur dy vite.

Kështu është shpjeguar sasia e mbetur, e cila nuk u përmend në tërësi në dhënien e zekatit të deveve, siç është shpjeguar gjithashtu edhe mosha e deveve. Po të mos ishte Suneti, nuk do ta dinim se si duhet dhënë zekati, edhe pse e kemi ditur obligueshmërinë e dhënies së zekatit nga Kur'ani, porse Suneti na ka shpjeguar sasinë e pasurisë që duhet të jepet për zekat si dhe e ka shpjeguar kohën në të cilën duhet të jepet, ngase nuk jemi të obliguar ta japim zekatin pa kaluar viti, përveçse në drithëra dhe fryte, që obligohemi t'i japim kur piqen: *"Dhe ditën e korrjes (të vjeljes) së fryteve jepeni atë pjesë që është obligim (të varfëve dhe nevojtarëve)."* (En Ena'amë: 141)

Allahu i Madhërishëm na urdhëroi për agjërimin e muajit Ramazan dhe kjo është një prej shtyllave të Islamit, por në Kuran nuk i ka shpjeguar dispozitat në tërësi, si kohën kur duhet agjëruar, gjërat që e prishin atë dhe gjërat prej të cilave agjëruesi duhet të largohet. Këto shpjegime kanë ardhur me detaje në Sunetin profetik.

Një urdhër i tillë ka ardhur edhe për kryerjen e haxhit, të vizituarit e shtëpisë së Allahut, subhanehu ue teala: *"Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtim tek ajo."* (Ali Imran: 97)

Ky ajet aludon se haxhi është obligim, por nuk na është shpjeguar koha e tij e as mënyra se si kryhet. Llojet e haxhit na i ka shpjeguar Pejgamberi,

lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, kur bëri haxhin e lamtumirës i pasuar nga një numër i madh njerëzish dhe tha: *"Merrni prej meje dispozitat e haxhit"*.¹³ Me këtë, Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, i shpjegoi llojet e haxhit një nga një dhe urdhëroi që ta marrim ashtu siç është transmetuar prej atyre që ishin të prani-shëm.

Allahu i Madhërishëm ka urdhëruar që t'i pritet dora vjedhësit: *"Vjedhësit dhe vjedhëses ua pritni duart, si ndëshkim për atë që kanë bërë"*. (El Maide: 38)

Por prerja ka kushte, të cilat nuk janë përmendur në Kur'an. Suneti ka sjellë shpjegimin e ajetit, duke treguar se nuk i pritet dora vjedhësit pa vjedhur shumën e përcaktuar, 1/4 e dinarit ose tre derhemë apo atë që është e barabartë me të. Në ajetin kur'anor nuk është shpjeguar cila dorë dhe vendi ku duhet të pritët ajo, por këtë e ka shpjeguar Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, i cili ka treguar se pritët dora e djathtë në nyjën e saj.

Allahu i Lartmadhërishëm na ka urdhëruar që t'i bindemi Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, dhe na ka lajmëruar se kush i bindet atij, i është bindur Allahut.

Ai thotë: *"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut."*(EnNisa: 80). Bindje ndaj Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, është edhe pasimi i asaj që ka ardhur prej tij dhe të vepruarit me të.

Allahu, subhanehu ue teala, thotë: *"Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj."*(El Hashr: 7)

Është urdhër nga Allahu, subhanehu ue teala, që të kapemi pas asaj që ka sjellë Pejgamberi, lavdërimi

¹³Shënon Muslimi, 2/349 nr. 1297.

dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, qofshin ato urdhëresa, ndalesa ose dispozita të tjera dhe që të ndalemi nga gjithçka që na ka ndaluar. Urdhri për bindje ka ardhur në forma të ndryshme; nganjëherë bindja ndaj tij krahasohet me bindjen ndaj Allahut subhanehu ue teala, në Kuran thuhet: **"O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja."**(En Nisaë: 59) dhe thuhet: **"Thuaj: "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit."**(Ali Imran: 32). Pra në këto vende bindja ndaj Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, është krahasuar me bindjen ndaj Allahut, subhanehu ue teala.

Nganjëherë bindja ndaj tij përmendet veçmas, sikurse në këto vende në Kuran:

- "Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut."(En Nisaë: 80)

- "Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!" (En Nurë: 56)

- "Ne nuk dërguam asnjë të Dërguar vetëm që me urdhrin e Allahut t'i binden atij." (En Nisaë: 64)

Allahu subhanehu ue teala na ka urdhëruar që kur biem në mospajtim për ndonjë çështje, t'i kthehemi librit të Tij (Kur'anit) dhe Sunetit të Pejgamberit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, për ta zgjidhur atë. Allahu i Madhëruar thotë: **"O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur."**(En Nisa: 59)

Kthimi tek Allahu, subhanehu ue teala, është kthimi te libri i tij (Kur'ani), kurse kthimi te Pejgamberi,

lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, është kthimi te Suneti i tij gjatë jetës së tij dhe pas saj.

Kthimi në këto burime është absolut deri në Ditën e Gjykimit. Kthimi te Suneti i Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, pas vdekjes së tij është i domosdoshëm ngase Suneti është bazë prerëse e kundërshtimeve mes umetit, qofshin ato dispozita fetare apo jo. Zgjidhja e këtyre kundërshtimeve është kthimi në Kur'an dhe Sunet. Kjo aludon se Suneti është krahasues i Kur'anit, bazë prej bazave të shariatit islam dhe i pashmangshëm për muslimanët në çdo kohë ose gjendje.

Allahu, subhanehu ue teala, u ka premtuar ndëshkim atyre që e kundërshtojnë Sunetin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Ai në Kuran thotë: *"Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj dhe frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër"*. (El Hashr: 7)

Dhe thotë: *"E nëse ata nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta."* (El Kasas: 50)

Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Të gjithë do të hyjnë në xhenet, përveç atij që ka refuzuar."* I thanë: "O i Dërguari i Allahut, e kush ka refuzuar?" Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: *"Kush më është bindur mua, ka hyrë në xhenet e kush më ka kundërshtuar mua, ka refuzuar."*¹⁴

Kush kundërshton Sunetin e tij ka refuzuar hyrjen në xhenet dhe është i kërcënuar me zjarr. *"Le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të Dërguarit), se ata do t'i zërë ndonjë telash ose do t'i godasë dënimi i hidhur."* (En Nurë: 63)

¹⁴Shënon Buhariu, 6/2655 nr. 6851.

Kërcënimi i rreptë ndaj atij që kundërshton urdhrin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, do të thotë së pari goditje me sprovë në zemrën e tij dhe devijim nga e vërteta, derisa të bëhet shkak për mosbesim dhe mosudhëzim drejt së vërtetës pas kësaj.

Nga fjala e Allahut *“ose do t'i godasë dënimi i hidhur”*, mësojmë se dënimi do të jetë në këtë botë me vrasje, sëmundje ose shkatërrim për kundërshtimin e urdhrin të Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, dhe pastaj dënim në botën e ardhshme.

Kush e kundërshton urdhrin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, nuk gjen shpëtim nga këto dy dënime: dënimi në zemër ose trup dhe ai me vdekje ose humbje të pasurisë e familjes. Ky është ndëshkimi i ashpër për atë që kundërshton urdhrin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të.

Allahu, subhanehu ue teala, thotë: *“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”*(El Ahzabë: 36)

Allahu i Madhëruar në këtë ajet na ka shpjeguar se si duhet të jene besimtarët, të cilët pasi tu bëhet e qartë urdhri i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij, nuk pranojnë të bëjnë përzgjedhje në këto urdhra, a t'i veprojnë apo jo, por i pranojnë duke qenë të kënaqur, qetësuar dhe të gëzuar, sepse urdhri i Allahut dhe i Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi qofshin mbi të është udhëzim dhe mirësi. Në anën tjetër nëse njeriu nuk punon me të dhe pretendon se ka të drejtë të përzgjedhë, atëherë ai ka devijuar me një

devijim të qartë. Devijimi apo humbja është e kundërta e udhëzimit dhe është cilësuar këtu si i tillë ngase ai ka kundërshtuar rrugën e drejtë.

Ajo që e qartëson dënimin e atij që kundërshton urdhrin e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij është hadithi që tregon për personin i cili ishte duke ngrënë me dorën e majtë dhe kur i Dërguari e urdhëroi që të hante me dorën e djathtë, iu përgjigj se nuk mundej. Por ai po gënjente sepse mundej, por mendjemadhësia e tij nuk e lejonte t'i nënshtrohej Sunetit. Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, iu drejtua me fjalët "mos mundsh". Bëri dua kundër tij dhe në atë moment ai e shtriu dorën, por nuk mundi ta çonte dot më te goja.¹⁵ Ky ishte ndëshkim i menjëhershëm për të, Allahu na mbrojtë prej tij! Ky është argument se kush e kundërshton me mendjemadhësi Sunetin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, e pret ndëshkimi. E kundërta e këtij shembulli është personi që mbante një unazë ari në gisht. Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, i tha: "*Kush prej jush e merr gacën dhe e vendos në dorë?*" Pastaj ia mori dhe e hodhi në tokë. Kur u largua Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, unaza ishte në tokë dhe pronari i saj ishte ende aty dhe të pranishmit i thanë: "Merre unazën tënde dhe përfito nga ajo." Ai ua ktheu: "Për Allahun! Nuk e marr atë që ka hedhur Pejgamberi."¹⁶ Shiko dallimin mes dy personave të lartpërmendur. I pari thotë nuk mundem nga mendjemadhësia, Allahu na mbrojtë prej saj, kurse i dyti betohet të mos e marrë unazën që ka hedhur Pejgamberi, lavdërimi dhe

¹⁵Shënon Muslimi, 3/1599 nr. 2021.

¹⁶ . Shënon Muslimi, 3/1655 nr. 2090.

shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Ky është shembull i besimit dhe i nënshtrimit të mrekullueshëm.

Le të përmendim një shembull tjetër të nënshtrimit ndaj Sunetit. Muslimanët në fillim të hixhretit faleshin në drejtim të xhamisë së Aksasë me urdhrin e Allahut subhanehu ue teala, pastaj Allahu i urdhëroi që të kthehen në drejtim të Qabes së ndershme: *"Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabes)."* (El Bekare:144)

Me ndërrimin e drejtimit të kiblës nga xhamia e Aksasë në drejtim të Qabes së ndershme, edhe muslimanët u kthyen nga Qabja e ndershme me urdhrin e Allahut subhanehu ue teala. Në fillim ishin duke u falur në drejtim të xhamisë së Aksasë sipas urdhrin të Allahut subhanehu ue teala: *"Të Allahut janë lindja dhe perëndimi, Ai udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë ."* (El Bekare:142)

Pastaj zbriti urdhri për t'u ndërruar kibla drejt Qabes së ndershme. Një grup sahabësh ishin duke falur namazin e ikindisë në drejtim të xhamisë së Aksasë sepse nuk u kishte shkuar lajmi për ndërrimin e kiblës. Tek ata shkoi një tjetër sahab dhe kur i pa në namaz, iu drejtu duke u thënë: "Kibla është ndërruar në drejtim të Qabes!" Në atë moment ata u kthyen në drejtim të Qabes së ndershme duke iu nënshtruar urdhrin të Allahut pa kundërshtim dhe pa pyetur. Ky është imani i sinqertë. Besimtari nënshtrohet kur e di se Allahu, subhanehu ue teala, ose Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka urdhëruar për një gjë të tillë. Allahu, subhanehu ue teala, na ka përmendur gjithashtu edhe gjendjen e atyre që i kanë zemrat e sëmura ose kanë syfaqësi në to.

"Disa mendjelehtë nga njerëzit do të thonë: "Çka i ktheu ata (muslimanët) prej kibles (drejtimit) në të cilin ishin (Kudsi)?" (El Bekare: 142)

Këta nuk shpejtojnë të nënshtrohen, por shpesh-tojnë të pyesin dhe të kundërshtojnë, kurse pasuesit e besimit nënshtrohen dhe nuk kundërshtojnë.

Këto janë disa pamje të pozitës së Sunetit profetik në gjokset e muslimanëve, të vepruarit me të dhe bindja ndaj tij, ngase është baza e dytë prej bazave të argumentimit në Islam. E madhërojnë, e nderojnë dhe e çiltërojnë sepse është fjala e Pejgamberit të tyre, i cili nuk flet nga hamendja. Në nënshttrimin ndaj tij ka bereqet dhe mirësi për umetin. Kjo duhet të jetë pozita e Sunetit të Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, në zemrat e muslimanëve në çfarëdo kohe që jetojnë. Ata e nderojnë dhe i nënshtrohen sikur të jenë duke e dëgjuar tani Pejgamberin, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, pasi ka ardhur në mënyrë të saktë me anë të zinxhirit të transmetimit dhe nuk ka vend për dyshime në të.

Besimtari i nënshtrohet dhe e praktikon atë për veten e tij dhe ua mëson të tjerëve, prandaj Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, thotë: *"Allahu ia ndriçoftë fytyrën atij që ka dëgjuar prej nesh hadith dhe e ka interpretuar atë ashtu siç e ka dëgjuar. Ndodh që i informuari (atij që i arrin hadithi) ta kuptojë më mirë se interpretuesi."*¹⁷

Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka inkurajuar për predikimin e Sunetit të tij për ata që vijnë pas nga umeti i tij, derisa të vijë Dita e Kiametit, siç tha në haxhin e lamtumirës në Arafat:

¹⁷Shënon Tirmidhiu, 5/34 nr. 2657.

“T’ia interpretojë i pranishmi atij që nuk është prezent, se ndodh që i informuari ta kuptojë më mirë se interpretuesi.”¹⁸

Nga ky urdhër i Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka ardhur edhe interesi i muslimanëve për Sunetin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, e studiuar dhe e mësuar përmendësh, duke u përqendruar me një përqendrim të madh që ka tejkaluar përpjekjet e popujve të tjerë. Nuk ka ndonjë popull paranesh që të jetë interesuar për gjurmët e Pejgamberëve të tyre sikurse umeti i Muhamedit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të.

Njerëzit e kanë mësuar përmendësh, e kanë studiuar dhe ia kanë predikuar të tjerëve gjeneratë pas gjenerate, e kanë ruajtur duke e mësuar dhe duke e shkruar. Në kohën e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ai e kishte ndaluar shkrimin e hadithit: *“Kush ka shkruar nga unë diçka, le ta fshijë atë.”¹⁹* Qëllimi ishte që të mos ngatërrohej hadithi me Kur’anin, që të mos mendonte dikush se ishte pjesë nga Kur’ani. Pastaj Pejgamberi ua lejoi disa sahabëve që ta shkruanin atë, si p.sh. Abdullah bin Amër bin Asit, Allahu qofshin i kënaqur me të. Ai shkruante çfarë dëgjonte nga Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, prandaj ishte ndër sahabët që ka transmetuar më shumë sepse i shkruante hadithet që dëgjonte, ndërsa shumica i jepnin rëndësi mësimit përmendësh më shumë sesa shkrimit, saqë udhëtonin nga Hixhazi (provincë në gadishulli Arabik) për në Egjipt për të kërkuar një hadith që u kishte shkruar me mund të madh disa sahabëve që jetonin atje. Kjo aludon për rëndësinë që i kushtuan hadithit.

¹⁸Shënon Buhariu, 1/37 nr. 67, dhe Muslimi 3/1305 nr. 1679.

¹⁹Shënon Muslimi, 4/2298 nr. 3004.

Pas kësaj, në kohën e kalifit të drejtë Omer Ibën Abdulaziz, Allahu qofshin i kënaqur me të, filloi klasifikimi i hadithit dhe shkrimi i tij. Shkrimi i hadithit përparoi dhe u shkruan librat autentikë të Sunetit, mesanijd²⁰, el xhevami²¹ dhe el meaxhim²² dhe u formuan koleksionet që gjenden sot në duart e muslimanëve.

Përmes përpjekjes së mrekullueshme dhe kontributit të dijetarëve të këtij umeti, Allahu, subhanehu ue teala, e ruajti Sunetin profetik prej shtimit dhe mangësisë dhe prej shpifësve e gënjeshtarëve. Ata vendosën rregulla precize për pranimin e transmetimit, sqaruan gjendjen e gënjeshtarëve, shpifësve, të dobëtëve dhe atyre që nuk u merret fjala në transmetim. Kjo është ruajtje e Sunetit dhe njëherazi edhe e Kuranit: ***"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij."*** (El Hixher: 9)

Allahu i Lartësuar ashtu siç e ruajti Kuranin nga shtojca dhe mangësia, e ruajti edhe Sunetin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, përmes transmetuesve, ngase Suneti e shpjegon, sqaron dhe e komenton Kuranin.

Duhet të kemi kujdes nga fraksionet, nga devijuesit, e keqja e të cilëve është e njohur në këtë kohë, pasi ata shfaqin dyshime në Sunet duke thënë se na mjafton Kurani dhe nuk kemi nevojë për Sunet, duke u argumentuar me fjalën e Allahut:

²⁰Shumësi i fjalës "Musned" dhe kështu emërtohen librat e hadithit që përcjellin hadithet duke i radhitur ato në bazë të sahabive që i transmetojnë.

²¹Shumësi i fjalës "Xhami" dhe janë për qëllim librat e haditheve që përmbledhin hadithe që kanë të bëjnë me të gjitha lëmit dhe shkencat; enciklopedi ose koleksion i haditheve.

²²Shumësi i fjalës "Muxhem" dhe kështu quhen librat e haditheve që në të radhiten hadithet në bazë të një rregulli, sikurse në bazë të shkronjave, emrave, prejardhjeve të transmetuesve, etj., fjalor i haditheve.

"Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë."(El En'amë: 38)

Dhe me ajetin: *"Sqarim për çdo send."* (En Nahl: 81).

Sipas tyre, Suneti nuk është plotësisht i sigurt, pasi është përcjellë nga individët dhe kanë frikë se mos këta transmetues kanë gabuar ose kanë gënjyer, ndërsa Kur'ani është i saktë. Ata thonë se na mjafton ai që është stabil, prerës dhe bindës dhe duhet të lihet ajo që ka dyshime. Allahu i mposhtë këta, pasi me këtë dëshirojnë të anulojnë shariatën, me një metodë të ndyrë dhe dinake. Ata nuk mund t'u thonë njerëzve lëreni shariatën, lëreni Islamin, por vijne me një metodë të ndyrë djallëzore, duke thënë punoni me Kuran, se ju mjafton ai. Ata e dinë se nëse anulohet Suneti, Allahu mos e lejoftë një gjë të tillë, anulohet edhe Kurani e pas kësaj anulohet shariatë në tërësi. Suneti është shpjeguesi i Kuranit dhe nëse i pasojmë këta dhe nuk punojmë me Sunet, si do të falemi, si do të agjërojmë, si do ta japim zekatin, si do ta kryejmë haxhin, si do ta dallojmë të lejuarën prej të ndaluarës në shitblerje dhe çështjet e tjera?

Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka paralajmëruar për këta njerëz dhe i ka mposhtur para katërmbëdhjetë shekujsh me fjalët: *"Do të ndodhë që do t'i arrijë hadithi im ndokujt që është i ngopur dhe i mbështetur në kolltukun e tij dhe thotë: "Mes nesh dhe jush është Kurani; çka ka lejuar ai e lejojmë dhe çka ka ndaluar e ndalojmë."* Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, thotë: *"Mua më është dhënë Kurani dhe së bashku me të edhe diçka e ngjashme (Suneti)."*²³

Ky hadith ka mrekulli të mëdha prej mrekullive profetike sepse ka ndodhur ajo që paralajmëroi

²³ Shih fusnotën numër 2.

Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, i cili na tërhoqi vërejtjen prej personave të tillë: *“Ai (Muhamedi) nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij.”*(En Nexhm: 3-4)

Ata thonë se Kurani ka ardhur me transmetime të shumta të sigurta deri te ne dhe se është i saktë, kurse Suneti ka ardhur me anë të transmetimeve më të pakta, se janë futur në të të meta dhe s'mund të jetë sikurse Kurani. Kjo thënie është e kotë dhe argument i përgënjeshtuar, ngase Suneti nuk ka ardhur spontanisht dhe nuk është si tregimet e poetëve. Për transmetimin e tij ka metoda dhe rregulla të vendosura nga dijetarët që e mësojnë atë përmendësh dhe kujdesen për të prej kohës së Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ue selem, e deri më sot, madje derisa të dëshirojë Allahu i Lartësuar. Suneti është i ruajtur, me mbikëqyrjen e Allahut dhe nuk i është lënë hapësirë askujt që të luajë me Sunetin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të.

Është transmetuar se hufadhët²⁴ e Sunetit kanë sqaruar gjendjen e çdo gënjeshtari dhe të dobëti, kanë shpjeguar gjendjen e transmetuesve të besueshëm, të cilët kanë qenë pjesë e zinxhirit transmetues gjatë përcjelljes së haditheve.

Suneti në shpirtat e muslimanëve është aq i vlefshëm, saqë nuk ka mundësi të bjerë në duart mëkatore ose ta marrin gënjeshtarët dhe shpifësit. Edhe sot vazhdon të jetë ashtu siç ka ardhur nga i Dërguari i Allahut, mbartet nëpërmjet njerëzve të besueshëm dhe është i shkruar në koleksionet e Sunetit duke mënjanuar dyshimet e atyre që shfaqin dyshime dhe të gënjeshtarëve. Kjo është prej mirë-

²⁴Njerëzit që studionin dhe mësonin përmendësh hadithet e Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të.

sisë dhe dhuntisë së Allahut të Madhërishëm për krijesat e Tij. Prej shpifjeve që bëhen ndaj Sunetit të Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, është edhe pretendimi se nuk lejohet të punojmë me të, por duhet të punojmë vetëm me Kuran. Ky person është mohues, njeri i dalë nga feja, pasi ka refuzuar bazën e dytë prej bazave të shariatit, që është Suneti i të Dërguarit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Ai sikur thotë "mos iu bindni Pejgamberit, por vetëm Allahut, subhanehu ue teala". Ai në këtë rast nuk i është bindur as Allahut as të Dërguarit të Tij, kur ne jemi të urdhëruar që t'i bindemi Pejgamberit me fjalët: *"Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj dhe frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër"*. (El Hashr: 7)

Dhe në ajetin: *"Ai (Muhamedi) nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij."* (En Nexhm: 3-4)

Ky grup që është shfaqur sot përbëhet nga studiues të cilët nuk e kanë marrë diturinë nga dijetarët, por nga librat. Kanë qenë nxënës të letrave dhe u bënë prej atyre që luajnë me Sunetin e Pejgamberit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, hadithet e vërteta i dobësojnë, të dobëtit i saktësojnë. Këta nuk kanë balancë mes shkencës së hadithit dhe degëve të saj, që të marrin një guxim të tillë.

Prej tyre duhet të kemi kujdes më shumë sesa nga grupi i parë, ngase injoranca e grupit të parë është e dukshme, kurse këta fshihen pas diturisë, se gjoja kanë dituri dhe njohje për këto çështje (por realiteti tregon të kundërtën). S'ka ndryshim e as fuqi pa ndihmën e Allahut.

E lusim Allahun që të na mundësojë të gjithëve sukses në dituri të dobishme dhe në vepra të mira dhe ta shohim të vërtetën e ta pasojmë, ta shohim të kotën e të na mundësojë largimin prej saj. Ai është i Plotfuqishëm. Lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij Muhamed.

Shkruar nga *Salih bin Fevzan el Fevzan* (Anëtar i Komisionit të Përhershëm për Fetva dhe anëtarë i Departamentit të Dijetarëve të Mëdhenj në Arabi Saudite, Riad)

Përshtati: Rashit Zylfiu, Rijad

Data: 5/2/2005 26/12/1425